

Roma, e patricëve apo e skllervëve?

Roma perandorake ngrihej mbi supet e miliona skllervëve, të cilët ndërtuan rrugët, monumentet dhe pallatet e saj, ndërsa elitës sunduese i siguronin një jetë me luks dhe privilegje. Triumfet e mëdha, pushtimet e pamëshirshme dhe shfaqjet e lavdishme të Romës ishin ndërtuar mbi një bazë të pabarazisë së skajshme sociale dhe ekonomike. Përgjatë shekujve, Roma krijoi një nga perandoritë më të fuqishme dhe më të gjata të historisë, por për ta ruajtur këtë fuqi, ajo u mbështet në një sistem të ngurtë klasash, ku skllëverit dhe të varfrit paguanin çmimin për mirëqenien e pakicës së pasur.

Në Romën e perandorëve, korrupsioni ishte pjesë përbërëse e jetës politike dhe ekonomike. Senatorët dhe zyrtarët e lartë përvetësonin toka, grumbullonin pasuri dhe forconin pushtetin e tyre në kurriz të popullsisë së zakonshme. Ndërkohë që perandorët organizonin lojëra luksoze dhe festa madhështore për të fituar mbështetjen e masave, shumica e popullit romakë vuante nga varfëria, pabarazia dhe padrejtësitë e përditshme. Elita romake grumbullonte pasuri të jashtëzakonshme nga grabitjet e territoreve të pushtuara dhe puna e skllervëve.

Një nga kryengritjet më të mëdha që sfidoi këtë sistem pabarazie ishte ajo e udhëhequr nga Spartaku, gladiatori trak që në vitet 73-71 p.e.s. ngriti mijëra skllervë në kryengritje kundër Republikës Romake. Kryengritja e Spartakut, një luftë për liri, tronditi zemrën e Perandorisë. Për disa vite, legjionet romake, të ndërtuara me disiplinë dhe përvojë, u vunë në vështirësi përballë forcës dhe vendosmërisë së skllervëve rebelë. Kjo ishte një shfaqje e përplasjes midis elitës së korruptuar dhe një klase të shtypur.

Historianët e Romës u përqendruan në ndërtimin e mitit të madhështisë së perandorisë dhe lavdisë së udhëheqësve të saj, ndërsa figurat që sfiduan këtë rend shpesh u shtypën jo vetëm me forcë, por edhe me heshtje historike. Spartaku është një shembull i qartë i mënyrës se si Roma jo vetëm që

shtypte fizikisht kundërshtarët e saj, por gjithashtu përpiqej t'i fshinte ata nga kujtesa historike.

Megjithatë, pas një seri betejash të përgjakshme, revolta u shtyp nga gjenerali Marcus Licinius Crassus, dhe Spartaku u vra në betejë. Për romakët, kjo ishte një fitore e madhe, por për kujtesën historike, ishte një akt i fshirjes.

Por pse Roma nuk e përkujtoi Spartakun, një nga kundërshtarët më të guximshëm të saj? Përgjigja lidhet me mënyrën se si Roma perandorake ndërtonte dhe manipulonte narrativën historike për të siguruar legjitimitetin e pushtetit të saj. Skllëverit, edhe pse përbënin një pjesë të madhe të popullsisë, nuk kishin statusin e qytetarëve dhe ishin thjesht mjete në sytë e romakëve. Revoltat e tyre konsideroheshin si kërcënime për stabilitetin social dhe ekonomik të perandorisë, dhe figura si Spartaku, që sfiduan këtë rend, nuk kishin vend në përkujtimin publik.

Në vend të përkujtimit të kryengritësve, Roma zgjodhi të lartësonte ata që e shtypën revoltën. Për shembull, Crassus, komandanti që mposhti Spartakun, fitoi njohje të madhe dhe mori pjesë në triumfet ushtarake. Ndërkohë, skllëverit e kapur u kryqëzuan përgjatë Via Appia, thuhet që ishin mbi 6000 skllervë, duke dhënë një mesazh të qartë se çdo akt rebelimi do të përballej me ndëshkime të pamëshirshme.

Ndryshe nga gjeneralët dhe perandorët që përkujtoheshin me statuja, monumente dhe shkrime historike, Spartaku dhe skllëverit e tij u zhdukën nga kjo kujtesë historike zyrtare. Një monument për një lider të skllervëve, që ngriti krye kundër Romës, do të ishte një fyerje për rendin romak dhe për idenë e tij të pavdekësisë. Në këtë kontekst, fshirja e Spartakut nga historia nuk ishte thjesht një neglizhencë, por një politikë e ndërgjegjshme për të zhdukur çdo kujtim që mund të frymëzonte rebelë të ardhshëm. ►

Megjithatë, historia ka treguar se figurat që sfidojnë tiraninë shpesh arrijnë të triumfojnë në kujtesën kolektive të njerëzimit, edhe nëse perandoritë përpiqen t'i heshtin. Spartaku është përgjithmonë, pavarësisht nga përpjekjet për t'i zhdukur. Sot në Romë nuk gjendet asnjë shenjë "zyrtare" për kujtimin e Spartakut dhe skllervëve mbi të cilët u ngrit ky qytet perandorak. ■

* * *

PUNËTORËT E KRUIJËS NË GREVË

Protesta e Punëtorëve të “Altek sh.p.k” në Krujë është një shembull që tregon se kur punëtorët bashkohen, fitojnë! Viti 2025 për punëtorët e fasonerisë “Altek sh.p.k” në Krujë nuk nisi me urime dhe gëzim, por me një padrejtësi. Pas më shumë se 20 vitesh ku shpërblimi i fundvitit ishte traditë, këtë herë kompania vendosi të mos e jepte fare – dhe atë pa asnjë paralajmërim! Punëtorët nuk pranuan të heshtin. Që në ditën e parë të punës pas festave, ata bojkotuan punën. Pas dy ditësh pritje pa asnjë përgjigje nga drejtuesit, më 7 janar ata dolën jashtë godinës dhe protestuan në oborrin e fabrikës. Kompania tentoi t'i qetësonte duke ofruar shpërblimin në disa këste, por punëtorët qëndruan të bashkuar dhe nuk pranuan. Në ditën e katërt, situata u tensionua më shumë: portat u mbyllën, drejtuesit thanë se shpërblimi nuk do të jepet, por punëtorët nuk u dorëzuan. Ata ishin të vendosur: “Nuk rifillojmë punën pa marrë shpërblimin!” Pas disa ditësh presioni dhe qëndrese të bashkuar, kompania u detyrua të paguajë 60% të shpërblimit menjëherë dhe premtoi se pjesën tjetër do ta jepte brenda muajit. Një fitore e rëndësishme për të gjithë. Le të jetë kjo protestë frymëzim për çdo punëtor dhe punëtorë! Mos e harro: nëse nuk ngrihesh për veten, askush nuk do ta bëjë për ty. Kur bashkohemi, bëhemi të fortë. Kur jemi të fortë, fitojmë! ■

OLIGARKIA ËSHTË SHKATËRRIM PËR PUNËTORINË

Oligarku shqiptar Samir Mane shfaqet në rënditjen e revistës "Forbes" si një nga njerëzit më të pasur në botë. Ai renditet i 2356 me një pasuri neto prej afro 1.4 miliardë \$.

Në këtë listë, pëdveç Samir Manes nuk është i përfshirë asnjë biznesmen nga shtetet fqinje të Ballkanit Perëndimor. Sepse normalisht, në vende relativisht të varfëra, vështirë që një sistem ekonomik i ndershem të prodhojë miliarderë. Madje të tillë nuk ka as Kroacia, as Sllovenia e as Bullgaria që tashmë janë pjesë e Bashkimit Europian. Por po ti referohemi pjesës tjetër të Ballkanit, janë gjithsej 12 biznesmenë në listë, 2 në Sllovaki, 1 në Rumani dhe 9 në Greqi.

Po të marrim në konsideratë 35 vite post-diktaturë nga viti 1990 deri në vitin 2025 (konvertuar në 12775 ditë) dhe të bëjmë një pjestim të thjeshtë, del si rezultat që çdo ditë, nga 1 Janari 1990 e deri më sot, Samir Mane kursen afërsisht 109'600\$. Nga ana tjetër, sipas Institutit të Statistikave, paga mesatare në Shqipëri është afërsisht 77'700 lekë (bruto), ku paga neto vështirë se i kalon 65'000ALL. Pra, një çift ku të dy personat paguhet me pagë mesatare, ata marrin afërsisht 130'000ALL/muaj ose 1250\$. E thënë ndryshe, një çift që paguhet me pagë mesatare në Shqipëri do të duhej të punonte 87,7 muaj ose 7 vjet e 4 muaj, pa ngrënë, pa pirë, pa paguar kredi/qera, pa planifikuar për të zgjeruar familjen, për të patur një fitim neto sa një ditë e Samir Manes që nga viti 1990 e deri më sot. Kësisoj, nëse për teoritë ekonomike pasuria nuk mund të jetë e pafundme, edhe pasuria ekstreme ë shpie në pabarazi po aq ekstreme, në vetëvete nuk është e natyrshme, por vjedhje e djersës dhe mundësisë për një jetë më të mirë të miliona njerëzve të punës. ■



ROSA LUXEMBURG STIFTUNG

Supported by Rosa Luxemburg Stiftung Southeast Europe with funds of the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ). This publication or parts of it can be used by others for free as long as they provide a proper reference to the original publication.

The content of the publication is the sole responsibility ICSE and does not necessarily reflect a position of RLS.

Diego Riviera, arti mbi mure

Diego Rivera është një piktor meksikan i shekullit XX, i konsideruar si themelues i artit mural dhe një nga piktorët më të rëndësishëm amerikanë e më tej i kohëve moderne. Temat e tij, thellësisht sociale dhe politike, trajtojnë jetën e fshatarëve të varfër, punëtorëve të qytetit dhe jetës kulturore të Amerikës periferike e native. ■



Jazra Khaleed, dy poezi

Jazra Khaleed konsiderohet si një nga zërat më të mirë të poezisë së re greke.

Natyrë e vdekur

Papunësia ime është metalike,
më gjymton.
Kam dy ditë pa ngrënë,
rris në barkun tim një furtunë.
Në lagjen time nuk lozin fëmijë;
sigurimsat mbajnë kapele jokey,
janë të dystë, ashtu si dhe mënyrat e
tyre urdhërore,
janë të dhëmbëzuar dhe pa mëngë;
ecin si garipa të fryrë, me krahët
hapur.
Në lagjen time, ditët kalojnë
kotësisht,
ndodhitë zbukurojnë muret,
lumturia kalbet nëpër gomisteri.
Në therrtoren e përditësisë shes
hanxharë,
Shkruaj nga një poezi sa herë që bëj
rrugën nga shtëpia në metro.
Në pritje të një mallëngjimi të
mundshëm. ■

Në këtë vend s'ka vend për manifeste

Në këtë vend s'ka vend për manifeste,
këtu therrim jetën mbi llamarinë,
këtu kthejmë veprat në fjalë,
këtu prodhojmë fjalët me metodën Fischer –
Tropsch:
nëse i hollon, zor se mbush me to një shishe
benzinë.
Në këtë vend s'ka vend për manifeste;
njerëzit kanë shteruar,
duhet t'i shtrydhësh,
që të mbushësh një trastë me gurë.
Manifesti është një send,
porsi tavolina ose krevati,
ka përmasa konkrete;
manifesti nuk është deklaratë,
ka gjatësi dhe gjerësi,
ngulet në mur me vida Allen M12x30.
Manifesti nuk ofron njohuri,
nuk është aktivitet politik në një sallë të okupuar
apo grafiti në ndonjë shkollë,
ka vetëm vlerë funksionale.
E kemi shumë të qartë se çfarë është manifesti,
por nuk arrijmë asnjëherë ta përtypim e ta tresim.

Në këtë vend, rrugët janë llogore,
sheshet sipërfaqe çarëse,
në thikën e bukës shkëlqen zifti.
Këtu, nuk mbin e lulëzon asgjë,
edhe pse e mbillnim dhe e plehëronim
çimenton çdo vjeshtë.
Është fati ynë i trashëguar,
rëniet e trupave tanë janë të përditshme,
dhe nuk ka ngelur më asgjë nga gjaku ynë,
që të digjet, që të vlejë.
Në këtë vend s'ka vend për manifeste;
Filozofët punojnë të gjithë në shtet,
poetët janë mikroborgjezë,
revolucionarët presin shpërblimin efapaks.
Këtu, ata që kanë fishekë i ruajnë për vete,
ata që veshin këpucë me vrma,
i bien çdo mëngjes fatit me shkelma,
ata që huajnë folje,
kthejnë pas vetëm kohët.
Këtu njerëzit fshihen brenda vetes,
periudha e drupreresjes zgjat me vite.
Ky vend nuk na nxë të shtrirë,
Ndaj vdesim gjithmonë në këmbë.
Në këtë vend s'ka vend për manifeste. ■

Viti III / Nr XIII

E mërkurë, 19 Mars 2025

Organizohu!

tel: 0692570076
e-mail: organizohu@gmail.com

PUNËTORËT NË PROTESTË

